



KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhvillimit Ekonomik

Nr. 016 - 21627/22

Klinë, datë 24.06.2022

PROCES VERBAL

Nga Debati me Publikun me lokalitetet: Gllarevë, Rixhevë, Zabërgjë dhe Stapanicë, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët “Dëshmorët e Qëndresës”, në fshatin Gllarevë. Tubimi u mbajt me datë 20 qershor 2022 dhe filloi në orën 18:30 dhe morën pjesë: 15 persona.

RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e paraqiti ushtruesi i detyrës së drejtorit të drejtorisë së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, z. Ajet Sejdiu, i cili paraqiti buxhetin për vitin 2023 dhe projektet e planifikuara.

Edhe kryetari i Komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, foli para të pranishmëve disa detaje nga ky dokument (Korniza Afatmesme Buxhetore), si dhe përmendi projektet të cilat janë duke u realizuar dhe janë realizuar në fshatrat Gllarevë, Rixhevë dhe Stapanicë. Gjithashtu veçoi projektin kryesor, ujësjellësin apo furnizimi me uji të pijës që realizohet në bashkëpunim me kompaninë zvicerane CDI.

DISKUTIMET

1. Tefik Morina nga fshati Gllarevë kishte si kërkesë kryesore rregullimin e ujerave të zeza të cilat ballafaqohen banorë e Gllarevës. Po ashtu kërkesë e tij ishte edhe rregullimi i rrugës kryesore "Ahmet Pantina" që lidhet me magjistrale Prishtinë-Pejë si dhe rrugën tjetër e cila kalon afër xhamisë "Mustafë Pantina" së fshatit Gllarevë.
2. Xhemë Manaj, banor i fshatit Gllarevë, kërkesë kishte rregullimin e disa rrugëve të cilat kanë filluar të prishen apo të behën me gropa te ndryshme dhe te asfaltohen.
3. Xhevdet Balaj, kërkesë kishte rregullimin e rrugës "Sylë dhe Milazim Balaj", shtrimin e saj me zhavorr për shkak të gjendjes së renduar të saj me gropa.
4. Visar Morina nga fshati Gllarevë, kërkesë kryesore ka furnizimin me uji të pijës për shkak të shterjes së puseve apo bunarëve te 5-6 shtëpive te lagjes "Morina". Ai gjithashtu tha se problem tjetër e sheh edhe dëmtimin e rrugëve dhe gropat e shumta në lagjen "Morina".
5. Zejnullah Pantina banor i fshatit Gllarevë ka kërkesë ndërtimin e parkut të fshatit gllarevë si dhe sigurimi i një mjeku në ambulanten e fshatit të paktën një here në javë. Gjithashtu, ai theksoi se kërkesë kryesore është ndërtimi i lokacionit të varrezave te fshatit Gllarevë.
6. Kamer Morina banor i fshatit Gllarevë, kërkesë ka rregullimin e rrugëve të dëmtuara nga vërshimet e shiut "Pranvera 81", rruga afër restaurant "Korneri".
7. Kërkes tjetër e banoreve të fshatit Gllarevë është edhe rregullimi i ndriçimit të rrugëve dhe lagjeve të fshatit Gllarevë.
8. Kërkes tjetër është rregullimi-riparimi i shkollës fillore të fshatit Gllarevë.

Takimi u mbyll në orën 19:22.

Procesmbajtësi

